



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 08.08.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **31.07.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "KO-MED" L.L.C. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK" - Lot 3 dhe Lot 4, me nr. prokurimi 206-24-3083-1-1-1, nxjerr:

**V E N D I M**

1. Refuzohet, si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "KO-MED" L.L.C. e dt. 31.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK" - Lot 3 dhe Lot 4, me nr. prokurimi 206-24-3083-1-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 26.07.2024.
2. Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 26.07.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit për Lot 3 dhe Lot 4;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik "KO-MED" L.L.C. me date 31.07.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK" - Lot 3 dhe Lot 4, me nr. prokurimi 206-24-3083-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 08.08.2024 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE "KO-MED" L.L.C.:

- Neni 1. Qëllimi
- Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 59. Ekzaminimi , Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60. Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 72. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me datën 26.07.2024 është publikuar Njoftimi Mbi Vendimin e AK, ku kemi marrë njoftimin mbi eliminimin tonë në këtë Aktivitetin të Prokurimit.

Me date 30.07.2024 kërkojmë qasje në dokumentacion dhe qasja na lejohet me datë 30.07.2024

Qasja ne dokumentacion na eshte lejuar mirepo per shkak te problemit me USB ne MSH nuk i kemi pranuar dokumentet ende.

Me 31.07.2024 parshtrijmë këtë **Kërkesë për Rishqyrtim për Lot 3 dhe Lot 4.**

Ne jemi eliminuar nga Lot 3 per kete arsye:

### **LOT 3 :**

Pozicioni 3 : Detection with CCD camera or filtered photodiodes.

Është ofruar teknologji PMT kurse është kërkuar Detection with CCD camera or filtered photodiodes.

*-Sqarimi nga KO MED L.L.C Lot 3: Se bashku me oferten tone ne e kemi bashkangjitur edhe deklaratën e prodhuesit (te nenshkruar dhe vulosur) se paisja me te cilen ne kemi ofertuar i ploteson te gjitha specifikat teknike te kerkuara dhe ne disa pozicione eshte edhe me e avancuar se paisja qe eshte kerkuar. PMT Teknologjia qe e kemi ofertuar ne ofron nje nivel te jashtzakonshem te sensitivitetit , qe nuk mund te arrihet nga sensorët tjer. Kjo mund te vertetohet edhe me nje hulumtim dhe krahasim te shkurter me teknologjite tjera.*

*Gjithashtu ne prap kemi kerkuar sqarim nga prodhuesi (bashkangjitur mund ta gjeni deklaratën nga prodhuesi).*

*Perderisa autoriteti kontraktues e ka lejuar te ofrohet me filtered photodiodes , PMT Teknologjia eshte e ndertuar bazuar ne filtered photodiodes veç se eshte teknologji edhe me e avancuar dhe me e sakt.*

*Ne i plotesojm te gjitha specifikat teknike dhe kete e kemi te deshmuar edhe me Deklarate nga Prodhuesi.*

Ne jemi eliminuar nga Lot 4 per kete arsye:

**Lot 4:**Processes up to 48 samples simultaneously.

Është kërkuar up to 48 samples simultaneously kurse është ofruar për 96 mostra.Nuk pranohet

*-Sqarimi nga KO MED L.L.C Lot 4: Eshte e pakuptimt se si per kete pike ne jemi shpallur te eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit per arsye se paisja qe ne kemi ofertuar e ploteson kete specifik dhe eshte edhe me e avancuar se qe eshte kerkuar.*

*Ne per kete pike kemi kerkuar sqarim edhe nga prodhuesi (bashkangjitur e gjeni deklaratën nga prodhuesi).*

GenePure 96 Sistemi i Pastrimit të Acidit Nukleik mund të përpunojë deri në 96 mostra njëkohësisht, por është gjithashtu e mundur të përpunohen më pak mostra, si p.sh. 6 mostra, 12 mostra, 18 mostra, 24 mostra, 30 mostra, 36 mostra, 42 mostra, 48 mostra.(aq sa eshte e nevojshme)

*Ne i plotesojm te gjitha specifikat teknike dhe kete e kemi te deshmuar edhe me Deklarate nga Prodhuesi.*



## HANGZHOU BIOER TECHNOLOGY CO., LTD

1192 BinAn Rd, Binjiang District, 310053 Hangzhou, P.R. China  
Tel: +86-571-87774575 Fax: +86-571-87772210  
Email: overseas@bioer.com.cn http://www.bioer.com.cn



### Statement

July 30, 2024

To Whom It May Concern,

We, Hangzhou Bioer Technology Co., Ltd., who are specialized in the Research, Development and Manufacturing of molecular diagnostics products, having factories at 1192 Bin An Rd., Hi-Tech (Binjiang) District, Hangzhou, 310053, China.

We hereby confirm the proposed product LineGene 9600 Plus Fluorescent Quantitative Detection System, 5 channels, catalog: BYQ6A94E, model: FQD-96A meets the required specifications of "3. Real Time PCR Machine". As for the point "Detection with CCD camera or filtered photodiodes", the LineGene 9600 Plus is with highly sensitive filtered photomultiplier (highly-sensitive PMT) for fluorescence detection. The highly sensitive filtered photomultiplier is upgraded detection technology based on filtered photodiodes and have better performance than filtered photodiodes. Thus, for this point, the LineGene 9600 Plus meets the requirement. Besides, we have installed over 2000 this instrument in a lot of different countries in international market. We believe the LineGene 9600 Plus can meet your needs.

We also confirm the proposed product GenePure 96 Nucleic Acid Purification System, catalog: BYQ6A30E, model: NPA-96E meet the required specification of "4. Automated nucleic acid purification instrument". As for the point "Processes up to 48 samples simultaneously", the GenePure 96 Nucleic Acid Purification System can process up to 96 samples simultaneously, but is also possible to process less samples, such as 6 samples, 12 samples, 18 samples, 24 samples, 30 samples, 36 samples, 42 samples, 48 samples. We have a full range of nucleic acid extraction kits for this system that can cover most applications needed on the market. We have also installed a lot of units in internation market.

We truly hope you can consider our solution and we believe you will be satisfied with our good quality and competitive price.

Yours faithfully,

Bryan Ling  
Sales Manager



Hangzhou Bioer Technology Co., Ltd.  
Address: 1192 Bin An Rd., Hi-Tech (Binjiang) District, Hangzhou, 310053, China  
www.bioer.com.cn

Në raste kur ka paqartësi apo mospërputhje në mes të dhënave, AK me qëllim të mbrojtjes së buxhetit të shtetit, duhet të shfrytëzoj nenin 72 të LPP-së, i cili është hartuar ekskluzivisht për këto raste me qëllim të sqarimeve dhe korrigjimeve, për të arritur te rezultati përfundimtar sa më i favorshëm për AK si për nga Çmimi më i lirë ashtu edhe për nga kualiteti i produkteve.

- AK ka bere shkelje te Neni 6 te LPP-se, duke marre parasysh se me eliminimin tone si ofertues i pergjegjshem, AK bie ndesh me paragrafin Nr. 1. Te nenit 6 ku specifikohet se: **Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.**

- AK ka bere shkelje te Neni 72 te LPP-se, duke marre parasysh se per te gjitha paqartësite gjate procesit te vleresimit ka mundur te kerkoje sqarime shtese ndaj nesh si ofertues i pergjegjshem me çmimin më të lirë, bazuar ne nenin Nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39 të RrUOPP-së.

**Duke u bazuar ne shkeljet qe u elaboruan me lart, kerkojme nga Autoriteti Kontraktues qe ti shqyrtoj pretendimet tona ankimore per te cilat ne jemi te bindur se jane te bazuara dhe si rrjedhoje te aprovari kerkesen tone per Rishqyrtim, ta anuloni Njoftimin mbi vendimin e AK te dates 26.07.2024 dhe lenden ta ktheni ne Rivleresim dhe oferta jone te trajtohet si e pergjegjshme.**

Ne te kunderten jemi te detyruar ti ndjekim rruget ligjore, per shkak te demtimit tone, trajtimit jo te barabarte dhe diskriminues ndaj nesh si operatore ekonomik i pergjegjshem me Çmimin më të lirë.

#### **Dëmet materiale**

Në rast të diskriminimit ndaj KOMED L.L.C, operatori Ekonomik është i detyruar të veprojë në mbrojtje të interesave të tij ekonomike dhe juridike duke kërkuar kompenzimin e plotë të dëmeve të shkaktuara.

#### **Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore**

Konstatojme se pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara, duke marre parasysh sqarimet e ofruara nga profesionistet si ne vijim:

Ju njoftoj se pas shyrtimit të deklaratës së prodhuesit që deklaroi që pajisja posedon PMT (is a single-pixel detector) dhe arsyetimin për rëndësin e saj ,ne po e përsërisim përgjigjen qe kemi dhëne edhe ne sqarimin e dosjes se tenderit:

**Lot 3: Real time PCR pozicioni 3: është kërkuar Detection with CCD camera or filtered photodiodes, Photo Multiplier Tube eshte tjetër teknologji e detektimit (PMT is a single-pixel detector).**

Nuk pranohet

Jemi përcaktuar për detektim me CCD kamere për shkak te natyrës se punës dhe përparësive qe ofron kjo teknologji si për shembull rezolucioni i lartë dhe ndjeshmëri e madhe qe është e rëndësishme ne raste delikate kur kemi te bëjmë me detektimin e patogjeneve ne sasi te vogla, skenon te gjithë spektrin eshte me e pershtatshme dhe gjithëpërfshirëse.

Sipas studimeve dhe përvojës sonë kjo teknologji është shume me e dobishme për zgjidhjen e problemeve tek llojet e analizave te cilat punohen ne laboratorin tone.



**Lot 4:** Automated nucleic acid purification instrument.

Është kërkuar pajisja që procedon deri në 48 mostra për arsye siç vijon:

Numri I mostrave që testohen në laboratorin tonë është i vogël dhe aparatura e cila analizon 96 mostra nuk është e nevojshme minimalisht kërkon 6 mostra të testohen, në rastet që i kemi të shpeshta kur testojmë një mostër material për 5 reaksione tjera hudhet dhe krijon shpenzime shtese të panevojshme të reagjentëve.

Si përmbledhje pajisja e përzgjedhur ka formatin deri në 48 mostra dhe mundëson testimin e mostrave një nga një pa shpenzuar për realimin e testit që e bën pajisjen e përshtatshme sa i përket kostove operacionale.

Per Lot 3 është e kjarë forma e kërkuar e detektimit CCD, e cila është konfirmuar edhe me sqarimet shtese të proceduara gjatë fazes së tenderimit me datën 03.05.2024.

**Lot 3:** pozicioni 3: është kërkuar Detection with CCD camera or filtered photodiodes, Photo Multiplier Tube është tjetër teknologji (PMT is a single-pixel detector). Nuk pranohet

Pas sqarimeve të lartcekura, si ZPP i AK-MSh kam kërkuar sqarime shtese të profesionistëve të NJK në lidhje me vertetesinë a arsyeve të eliminimit për Lot 4, dhe kam marrë përgjigjet me sqarime si më poshtë:

**Pyetja 1:** Është kërkuar pajisja që proceson deri në 48 mostra. A lejohet ky numër të tejkalohet apo ky është tavan? Duke qenë se ankuesi ka ofruar pajisje me 96 mostra dhe shpejtësi prej 8 minutave.

**Përgjigja:** Po, është saktësisht e kërkuar pajisja me maksimum 48 teste, sepse ky model i përgjigjet kapaciteteve tona apo vëllimit të punës në laboratorin për tuberkuloze. Andaj kapaciteti i punës është i vogël dhe nuk kemi nevojë për pajisje me 96 teste. Për këtë arsye, kemi kërkuar që maksimumi të jetë deri në 48 teste.

**Pyetja 2:** A po nënkupton kjo që pajisja e OE ankues minimalisht kërkon 6 mostra të testohen njëkohësisht, dhe nuk ka mundësi testimi për 1, 2, ose 3 mostra?

**Përgjigja:** Po, në katalogun e ofruar nga ankuesi, shkruan kështu: "The minimum amount of the purification reagent is 6 tests to meet the different need of the customer," që do të thotë shpenzohen 6 teste në një seri. Kjo do të thotë se për testimin e një mostër të vetme harxhohen edhe 5 të tjera, duke shkaktuar shpenzime të panevojshme për laboratorin tonë.

**Pyetja 3:** Në rastet kur testojmë një mostër material për 5 reaksione tjera, krijohen shpenzime të panevojshme të reagjentëve. A nënkupton kjo që pajisja e OE ankuese nuk e mundëson testimin e mostrave një nga një, dhe material për 5 reaksione tjera hudhet dhe krijon shpenzime shtese të panevojshme të reagjentëve?

**Përgjigja:** Po, në pajisjen e ofruar nga ankuesi, shpenzohen 6 teste në një seri, që do të thotë se për një mostër të vetme harxhohen edhe 5 të tjera, gjë që shkakton shpenzime të panevojshme për laboratorin tonë.

**Pyetja 4:** A dëshmohet në katalog/brosurë se pajisja e OE ankues nuk e mundëson testimin e mostrave një nga një, ndërsa e OE të rekomanduar e mundëson një gjë të tillë?

**Përgjigja:** Në katalogun/brosurën e OE ankuese, shënohet "**The minimum amount of the purification reagent is 6 tests to meet the different need of the customer,**" që nënkupton se nëse laboratori ynë ka nevojë të punojë vetëm 1 test, 5 të tjerë duhen të shkojnë dëm. Nga përvoja jonë dhe në katalogun e OE të rekomanduar, tek pjesa e specifikave shënohet "Pre-filled cartridge available in 4 (1T) 1 Test," që nënkupton se për një test nevojiten 4 kubëza (wells) me material të dedikuar për të punuar një test.

**Pyetja 5:** A ka qenë kërkesë e juaja në tender që pajisja duhet të mundësojë edhe testimin e mostrave një nga një?

Përgjigjja: Jo, nuk ka qenë kërkesë, por nënkuptohet që testimet një nga një janë përparësi e padiskutueshme dhe nuk shkaktojnë harxhime të panevojshme.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se laboratorin ynë do t'i përdorë këto aparatura për teste molekulare të tuberkulozit, të cilat janë teste të ndjeshme dhe shumë të rëndësishme për diagnostikimin e saktë të kësaj sëmundje.

Pajisja e kërkuar është me maksimum 48 teste, sepse kapaciteti ynë është i vogël dhe nuk kemi nevojë për pajisje me 96 teste. Për këtë arsye, kemi kërkuar që maksimumi të jetë deri në 48 teste.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit